

# RAPORT I FORUMIT POLITIK

INTEGRIMI I AGJENDËS 2030 NË KUADRIN E PLANIFIKIMIT  
STRATEGJIK DHE HAPAT TUTJE





---

# Përmbajtja

**04 |** Hyrje

**05 |** Për projektin 'Zbatimi, monitorimi dhe raportimi i Agjendës 2030 në Evropën Juglindore: Rasti i Kosovës'

**06 |** Përshkrimi dhe objektivat kyçe të Forumit Politik dhe Punëtorisë Nacionale

**07 |** Ndarja dhe kontributi i pjesëmarrësve në tryeza diskutimi dhe grupe punuese

**09 |** Ngjarja hapëse dhe fjalët hyrëse të përfaqësuesve të nivelit të lartë politik

**11 |** Tryeza diskutuese me titull 'Hartëzimi social për Qasjen Gjithëpërfshirëse – kornizë udhëzuese për hartimin e politikave të bazuara në të dhëna në nivel lokal'

**12 |** Tryeza diskutuese me titull 'Një perspektivë e përgjithshme mbi sfidat e mbledhjes së të dhënave në nivel kombëtar në Kosovë: Si ndikon mungesa e të dhënave cilësore në zbatimin e duhur të Agjendës 2030'

**13 |** Tryeza diskutuese me titull 'Partneritetet dhe bashkëpunimet ndërsektoriale për zhvillim të qëndrueshëm: Roli i sektorit privat sa i përket 'rritjes së gjelbër'

**14 |** Zotimi i institucioneve për bashkëpunim të vazhdueshëm

**15 |** Rekomandimet e dala nga grupet punuese

**16 |** Shtojcat

# SHKURTESAT

---

AKK - Asociacioni i Komunave të Kosovës

ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës

BE - Bashkimi Evropian

BMZ - Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim  
Ekonomik

CSR - Organizata për përgjegjësinë sociale të korporatave

GIZ - Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit

HANDIKOS - Shoqata e Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve të  
Kosovës

INDEP - Instituti për Politika Zhvillimore

KZhQ - Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm

MINT - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

MFPT - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

NALAS - Rrjeti i Asociacioneve të Autoriteteve Lokale në Evropën  
Juglindore

OBSH - Organizata Botërore e Shëndetësisë

OZhQ - Objektivet për Zhvillim të Qëndrueshëm

UNKT - Ekipi i Kombeve të Bashkuara

UNDP - Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

VNR - Voluntary National Review

ZPS - Zyra e Planifikimit Strategjik

---

## Hyrje

Për të avancuar me shpejtësi Agjendën 2030 dhe për të arritur një të ardhme të qëndrueshme për të gjithë kërkohet angazhim gjithëpërfshirës dhe proaktiv nga palë të ndryshme të interesit. Këtu përfshihen akterë të rëndësishëm si institucionet qendrore e lokale, organizata ndërkombëtare e lokale, entitete nga sektori privat si dhe pjesëmarrja aktive nga akademja. Kjo qasje gjithëpërfshirëse e shoqërisë e aplikuar globalisht garanton minimalisht promovimin si dhe rishikimin e zbatimit e duhur të Agjendës 2030. Meqenëse Kosova nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara, nuk e ka për detyrë të zbatojë dhe të raportoje mbi Agjendën 2030 dhe përmbushjen e OZhQ-ve, mirëpo Kosova tashmë ka filluar me hapa të ngadaltë të përfshihet në zbatimin e kësaj Agjende, edhe pse ende mbetet prapa në ngritjen e vetëdijes si dhe fillimin e punës me hapa më progresivë në këtë drejtim, përkundër iniciativave të ndryshme të marra nga akterë lokal dhe ndërkombëtar në fillimin e punës në zbatimin e kësaj Agjende. Për këtë arsye përfshirja e akterëve të ndryshëm nga sektore të ndryshme është e domosdoshme në avancimin e Agjendës 2030 dhe siguron mbushjen e boshllëqëve të vërejtura dukshëm në nivel vendi për zbatimin e Agjendës, si dhe shpërfaq hapa pasues që duhet të ndërmerren në mënyrë urgjente. Qasja gjithëpërfshirëse e shoqërisë ndër tjerash nënkupton krijimin e një ure bashkëpunuese midis palëve të ndryshme të interesit për të mundur një partneritet produktiv dhe hapa konkret drejtë shtyerjes përpara të Agjendës 2030 dhe përmbushjes së Objektivëve të Qëndrueshëm (OZhQ-ve). Vendosjen e një dialogu mes akterëve të rinjë të përfshirë, si dhe përmirësimin e dialogut mes palëve të tradicionale për zbatimin e Agjendës është hap esencial për tu marrë në kohën kur vetëdijësimi mbi këtë temë nuk është ende në nivelin e duhur.

Përmes krijimit dhe stabilizimit të këtij dialogu në mes të këtyre palëve të interesuar, dhe përmes gjetjeve dhe të dhënave të mbledhura nga këto dialoge synohet të mbështetet Qeveria në përpilimin e Raportit Vullnetar Kombëtar (ANG: VNR-s). Ky dokument do të ofrojë informata lidhur me përvojat e përgjithshme, sfidat, mësimet dhe sukseset e arritura drejt avancimit të Agjendës 2030. Gjithashtu, ky dokument është instrument për hartimin dhe forcimin e kornizës institucionale dhe zhvillimin e strategjive dhe politikave të duhura për të zbatuar Agjendën 2030. Ky dokument jo vetëm që do të tregojë gjendjen ku qëndron Kosova në raport me zbatimin e Agjendës 2030 dhe OZhQ-ve por njëkohësisht do të bënte të qartë rrugën e procesit të zbatimit të agjendës. Për më tepër dokumenti do të bënte më të dukshme nivelin e transparencës dhe do të mbante patjetër nën petkun e përgjegjësisë institucionet dhe akterët relevantë për zbatimin e Agjendës 2030, duke pasur parasysh që në kushtet e tanishme përgjegjësia për zbatimin e Agjendës 2030 bie vetëm mbi Këshillin e Zhvillimit të Qëndrueshëm si një grup jo-formal në kuadrin e pushtetit legjislativ.

Një ndër hapat konkret për të diskutuar, propozuar e punuar me hisedarë përkatës për arritjen e objektivave të lartshënuara ka qenë edhe organizimi i një ngjarje të madhe dy-ditore si Forumi i Lartë Politik, në kuadër të të cilit janë shënuar aktivitete si: tryeza diskutuese me përfaqësues të institucioneve zyrtare të nivelit lokal e qendror, organizata ndërkombëtare e lokale, agjenci të pavarura e entitete nga sektori privat. Të njëjtat janë ndarë në grupe punuese të ndryshme dhe kanë punuar bashkarisht duke nxjerrë ide përmirësuese për mekanizmin koordinues për përmbushjen e OZhQ-ve, gjithashtu duke propozuar ide për integrimin e kësaj Agjende në cdo dokument strategjik

të institucioneve publike e private, si dhe ide të tjera për ngritjen e vetëdijës në nivel të përgjithshëm sa i përket kësaj Agjende.

Ky raport trajton dhe përmbledh të gjitha aktivitetet e forumit të lartë politik të mbajtur në kuadër të projekteve rajonale të cilat janë zbatuar në bashkëpunim me AKK dhe janë mbështetur nga GIZ dhe NALAS. Raporti shpalos qëllimin e ngjarjes, objektivat e ngjarjes që ndërlidhen me ato të projektit në tërësi, aktivitetet brenda Forumit si dhe rekomandimet e dala nga grupet punuese. Të dhënat e mbledhura nga ky Forum krijojnë bazën për dokumentimin e grupeve punuese, veçanërisht dy grupet e punës kanë shërbyer si një udhërrëfyes në zhvillimin e masave dhe aktiviteteve të mëtejshme në nivel qendror në lidhje me politik-bërjen dhe do të parashikojnë veprime konkrete si dhe hapa për vendosjen e koordinimit ndërmjet institucioneve të nivelit lokal dhe qendror.

## Për projektin ‘Zbatimi, monitorimi dhe raportimi i Agjendës 2030 në Evropën Juglindore: Rasti i Kosovës’

INDEP që nga viti 2019, në bashkëpunim me AKK ka filluar zbatimin e projekteve rajonale me fokus në ngritjen e kapaciteteve të komunave në aplikimin e hartës sociale “Qasja Gjithëpërfshirëse” dhe në procesin e Lokalizimit të OZhQ-ve. Projekti regional **“Të drejtat sociale për grupet e cenueshme II” (SoRi II)** është zbatuar dhe vazhdon të zbatohet në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe punon në nivele lokale, qendrore dhe rajonale në pesë vendet e Ballkanit Perëndimor si Kosovën, Maqedoninë e Veriut, Bosnjën dhe Hercegovinën, Serbinë dhe Malin e Zi. Ky bashkëpunim rajonal është bërë me qëllim që të bëhet shkëmbimi rajonal të praktikave të mira dhe zhvillimi i kapaciteteve të akterëve përkatës publik dhe të tjerë në fushën e të drejtave sociale dhe të njeriut dhe përfshirjen e grupeve vullnetare, duke synuar përmes këtyre përmbushjen e Objektivëve të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe avancimin e Agjendës 2030. Projekti **“Mësimi Rajonal për Zbatimin e Agjendës 2030 në Evropën Juglindore (veçanërisht Maqedonia e Veriut dhe Kosova) – SFF Agenda 2030”** (SFF Agenda 2030) synon të përmirësojë kushtet për zbatimin e Agjendës 2030 dhe raportimin në Ballkanin Perëndimor përmes shkëmbimit rajonal, rrjetëzimit dhe mësimi (me fokus në Maqedoninë e Veriut dhe Kosovën). Të dy projektet ndajnë aktivitetet që përpiqen të kontribuojnë në zhvillimin e kapaciteteve të organeve koordinuese të OZhQ-ve në nivel qendror si dhe në mbështetjen e komunave në zhvillimin e kapaciteteve për lokalizimin e OZhQ-ve. Për implementimet e suksesshme të të dyja projekteve INDEP ka implementuar projektin në bashkëpunim me AKK, me të cilën kanë bashkëpunuar dhe kanë koordinuar punët sidomos në nivelin lokal. Për më tepër, të dy projektet mbështeten nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ), Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) si dhe bashkëpunojnë edhe me Rrjetin e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale në Evropën Juglindore (NALAS) si partner i tyre i përbashkët politik.

Duke marrë parasysh që ky projekt bashkëpunimi përfshin institucione, autoritete dhe organizata të ndryshme, duhet kuptuar që rolet dhe kontributet e tyre në këtë proces janë të ndryshme, njëjtë sikur motivet e tyre për të marrë pjesë në këtë proces. Në këtë drejtim, përveç që shoqëria civile përfaqëson interesat dhe nevojat e grupeve të ndryshme shoqërore, ajo është e interesuar për të

marrë pjesë në procesin e zbatimit të Agjendës 2030 pasi e shoh si mjet për të promovuar përpjekjet e saja dhe për të rritur ndikimin në politikë-bërje. Nga ana tjetër, sektori privat e konsideron këtë proces si mundësi për të rritur në mënyrë të qëndrueshme entitetet ekonomike dhe për t'u bërë më të përgjegjshëm ndaj shoqërisë, si dhe për të ndërtuar imazh të fortë në komunitet.

Në kuadër të këtyre dy projekteve është propozuar mbajtja e një forumi të lartë politik dhe një punëtorie nacionale. Ky organizim i përbashkët kontribuon në objektivet e dy projekteve dhe ndihmon të gjithë partnerët bashkëpunues në arritjen e treguesve dhe synimeve të projektit përkatës dhe përmes këtij organizimi është synuar dhe arritur niveli më i lartë i koordinimit dhe bashkëpunimit gjatë mbajtjes së forumit politik dhe punëtorisë nacionale të titulluar **'Integrimi i Agjendës 2030 në kuadrin e planifikimit strategjik në Kosovë dhe hapat tutje'**

## Përshkrimi dhe objektivat kyçe të Forumit Politik dhe Punëtorisë Nacionale

Meqenëse zbatimi i projekteve ka qëllim kryesor krijimin e kushteve për zbatimin, monitorimin dhe raportimin për Agjendën 2030 dhe përmbushjen e OZhQ-ve në Kosovë përmes dialogut dhe bashkëpunimit sistematik nga hisedarë të ndryshëm relevant, u mbajt Forumi i lartë politik **me datën 24 dhe 25 nëntor në Hotel Emerald, Prishtinë**. Forumi politik pati në përbërje tryeza diskutimi dhe grupe punuese, përmes të cilave u synua përqendrimi i vëmendjes nga ana e institucioneve në sfidat sistematike me të cilat përballen akterët që punojnë për një qasje gjithëpërfshirëse si dhe krijimi i dialogeve ndër-sektoriale duke përfshirë të gjithë akterët relevantë për avancimin e Agjendës.

Përveç që ky forum ka mbledhur në një hapësirë hisedarë të ndryshëm duke filluar që nga institucionet zyrtare të Republikës së Kosovës, organizatat ndërkombëtare, organizatat e shoqërisë civile vendore, sektorin privat e hisedarë të tjerë të kyçur në zbatimin e Agjendës 2030 dhe OZhQ-ve në Kosovë, forumi ka krijuar bazë për koordinim dhe partneritet sectorial dhe ndër-institucional përmes nënshkrimit të një Deklarate të Përbashkët për bashkëpunim dhe përpilimit të tri raporteve të ndryshme të cilat do t'i dorëzohen Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm. Kjo ngjarje u mbajt në format hybrid, me të pranishëm në sallë, dhe me transmetim direkt në rrjetet sociale të institutit INDEP dhe organizatës AKK.



*Fig 1: Ikonat e Objektivëve për Zhvillim të Qëndrueshëm*

Krahas objektivës së parë të synuar për të mbledhur në një hapësirë, dhe për të përfshirë të gjithë hisedarë relevant në dialogun koordinues për avancimin e Agjendës 2030, forumi kishte për objektive prezantimin e rezultateve konkrete të dalta nga procesi i mbledhjes së të dhënave nga grupet tematike për një qasje gjithëpërfshirëse në nivel lokal, të nxirren në formë të shkruar

rekomandime për mekanizmin për përmirësimin dhe shkëmbimin e të dhënave të mbledhura në nivele qendrore dhe lokale e anasjelltas, me qëllim të përmirësimit të politikave për avancimin e Agjendës 2030, nxerrjen e rekomandimeve të reja për përmirësimin e punës së organit koordinues për Agjendën 2030 si dhe zotimin e institucioneve përkatëse për vazhdimësinë e punës në këtë fushë përmes nënshkrimit të *Deklaratave të Përbashkëta*. Ndër tjerash gjatë Forumit Politik u mbajt sesion ligjërues mbi procesin e përpilimit të VNR-së, dhe parakushtet që duhet plotësuar për fillimin e procesit të raportimit. Ky sesion u mbajt nga znj. Ana Jovanovska, ish-koordinatore për OZhQ-të në Qeverinë e Maqedonisë së Veriut. Pjesëmarrësit patën mundësi të dëgjojnë informata të detajuara mbi këtë proces dhe të qartësojnë dyshimet paraprake për përpilimin e këtij raporti. Ndër tjerash, gjatë tryezave diskutuese u përmend që Kosova ka vullnet politik për të ecur rpara me këtë proces.

## Ndarja dhe kontributi i pjesëmarrësve në tryeza diskutimi dhe grupe punuese

Për të kontribuar dhe participuar në mënyrë aktive, të ftuar në Forum kanë qenë pjesëmarrës të ndryshëm të stafit politik dhe civil nga niveli lokal e qendror të institucioneve zyrtare të Republikës së Kosovës. Të pranishëm të tjerë kanë qenë përfaqësues nga Agjencitë e Pavarura, përfaqësues nga organizata të ndryshme ndërkombëtare si dhe entite nga sektori privat. Në dy ndarjet e Forumit, tryezat diskutuese si dhe grupe punuese kanë kontribuar 80 pjesëmarrës që përfaqësojnë institucionet e nivelit qendror nga Kosova; përfaqësues të institucioneve zyrtare të nivelit lokal, organizata ndërkombëtare e lokale, agjenci të pavarura, entitete nga sektori privat, si dhe pjestarë të Akademisë. Të pranishëm në ngjarje ishin edhe përfaqësuesit e katër komunave që kanë përfituar nga punëtoritë mbi 'Lokalizimin e OZhQ-ve nëpër komunat e Kosovës' si aktivitet i këtij projekti.



Fig 2: Pamje nga Forumi Politik i OZhQ-ve

Tryezat e diskutimit dhe dy grupet punuese kanë pasur në përbërje pjesëmarrësit e lartpërmendur. Tryezat e diskutimit kanë trajtuar tema nga më të ndryshme, gjithmonë duke propozuar mënyra të reja bashkëpunimi në mes të institucioneve përkatëse në drejtim të përparimit, duke filluar nga prezantimi i të gjeturave të hartëzimit social në komunën e Hanit të Elezit dhe Vitisë si dhe diskutimit rreth të gjeturave nga ky raport prej hisedarëve përkatës, e duke vazhduar te tryeza e radhës e cila ka trajtuar mungesën e të dhënave cilësore në nivel vendi, duke u fokusuar më shumë në të dhënat e nevojshme për të zbatuar Agjendën 2030 dhe përmbushur OZhQ-të, në të cilën diskutim kanë marrë pjesë ekspertë për mbledhjen e përpunimin e të dhënave, institucione relevante e anëtarë të Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm. Të gjithë këta akterë kanë diskutuar mundësitë për të përmirësuar këtë dukuri. Tryeza e fundit e diskutimit ka pasur në përbërje entitete nga sektori



privat, organizata vendore e ndërkombëtare të mbledhura bashkë për të diskutuar sfidat dhe mundësitë e bashkëpunimeve ndërsektoriale për zhvillim të qëndrueshëm, me fokus në rolin e sektorit privat për të kontribuar në përmbushjen e OZhQ-ve dhe përparimin e Agjendës 2030.



*Fig. 3 dhe 4: Grupet punuese me përfaqësues të institucioneve të nivelit lokal dhe qendror*

Grupet punuese ishin gjithashtu pjesë shumë e rëndësishme e Forumit, duke përfshirë dhe ndarë të gjithë pjesëmarrësit në dy grupe të ndryshme. Grupi i parë punues me moderator Dardan Abazin, nga ekipi i INDEP, punoj ngushtë me akterë lokal si zyrtarë dhe drejtor të drejtorive në komunat e Kosovës, përfaqësues të AKK si dhe organizata vendore, fillimisht për të prezantuar metodologjinë dhe të gjeturat e hartëzimit social në komunat e Hanit të Elezit dhe Vitisë për Parimin e Gjithëpërfshirjes (Mos lënja e askujt prapa) si storje sukcesi. Këto komuna kanë përafuar me sukses planet e tyre komunale të mbrojtjes dhe asistimit social në bazë të të dhënave të mbledhura në nivel lokal. Për më tepër grupi punues në fjalë trajtoj dhe propozoj mënyra të reja për koordinim lokal dhe qendror për zbatimin e duhur të Agjendës 2030.

Grupi i dytë punues me moderuese Learta Hollaj pati në përbërje përfaqësues të institucioneve të nivelit qendror, institucionin e Avokatit të Popullit, agjenci të pavarura, AKK, entitete nga sektori privat, ASK-në e organizata lokale. Ky grup punues pati për synim hartimin e rekomandimeve që do të ndihmojnë në përmirësimin e projektit të planit të veprimit i cili është krijuar nga Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm me synim zbatimin e Agjendës 2030, pastaj reflektimin e rekomandimeve nga hartëzimisocial në këtë plan të veprimit dhe gjithashtu vendosjen e hartëzimit social në strategjinë e KZhQ-së. Tutje, grupi punues diskutoj dhe propozojë ide të reja për ristrukturimin e KZhQ-së, si themelimin e sekretariatit të Këshillit i cili do të koordinonte punën e Këshillit dhe do të siguronte që puna e tij të vazhdojë përtej destabiliteteve të mundshme politike si dhe formimin e grupeve teknike të punës, të cilët do të thirren në bazë të nevojave. Atyre do t'u kërkohet të punojnë në tema të veçanta në përputhje me nevojat e identifikuara të Këshillit. Poashtu shtimin e anëtarëve të rinj si palë të interesit në Këshillin si entitet politik i cili është përgjegjës për hartimin e politikave dhe veprimeve udhëzuese dhe të përshtatshme për të çuar përpara zbatimin e Agjendës 2030.



## Ngjarja hapëse dhe fjalët hyrëse të përfaqësuesve të nivelit të lartë politik

Forumi Politik nisi me ngjarjen hapëse, e cila u mbajt me 24 Nëntor, dhe pati në përbërjen e saj përfaqësues zyrtarë të institucioneve e organizatave ndërkombëtare e vendore. Folësit në fjalë si të ftuar të ngjarjes hapëse ishin: z. Getoar Mjeku, zv. Ministër i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, znj. Fatmire Kollçaku Mullhaxha, Kryesuese e Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm në Kuvendin e Republikës së Kosovës, znj. Maria Suokko, Ushtruese e detyrës së Koordinatorës për zhvillim nga Kombet e Bashkuara, si dhe përfaqësuese rezidente e UNDP-së, z. David Oberhuber, Drejtor i GIZ Kosovo dhe Maqedonisë së Veriut, z. Joachim Roth, Zyrtar i BE-së në Rrjetin e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore (NALAS), z. Sazan Ibrahim, Drejtor Ekzekutiv i AKK-së, si dhe z. Burim Ejupi, Drejtor Ekzekutiv i INDEP-it, të cilët përshëndetën iniciativën dhe shprehën mbështetjen e institucioneve të tyre për avancimin e Agjendës 2030 dhe OZhQ-ve në vend.



Fig 5: Zv. Ministrit Mjeku gjatë fjalimit të tij në Forumin Politik të Agjendës 2030

Këta folës të nivelit më të lartë përfaqësuan institucione e organizata të ndryshme dhe treguan vullnetin e dëshirën për të punuar bashkë drejtë zbatimit të Agjendës 2030. Folësi i parë Zv. Ministri i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë z. Getoar Mjeku në fjalimin e tij përmendi se Qeveria Kurti ka vullnet të madh të bazojë strategjitë e zhvillimit ekonomik, shoqëror e mjedisor në Agjendën 2030 dhe OZhQ-të, rrjedhimisht duke treguar se edhe MINT do të bëjë përpjekje të realizojë planet dhe synimet e saj duke u bazuar në objektivet për zhvillim të qëndrueshëm. Tutje zv. Ministri deklaroi se Mint në planin operacional ka disa qëllime strategjike të cilat lidhen kryesisht me objektivin 16, e të cilat përpjekje janë synuar edhe me organizimin e këtij Forumi. Në planin operacional të MINT, zv. Ministri Mjeku përmendi disa nga objektivat kryesore si: përmirësimin e mjedisit për operimin më të lehtë të entiteteve private (bizneseve), zhvillimin e konkureshmërisë të sektorit privat, zhvillimin e industrisë vendore përmes inicimit të konkurrencës më të madhe në mënyrë që ndërmarrësit të përparojnë dhe që tregtia të jetë njëkohësisht e ekuilibruar. Tutje, zv. Ministri Mjeku në fjalimin e tij ndër tjerash përmendi edhe se zhvillimi i industrisë së inovacionit, nixitja dhe përkrahja e investimeve të huaja është e domosdoshme pa lënë anash investimet vendore, përmirësimin e cilësisë së infrastrukturës dhe mbrojtjen e konsumatorit, zhvillimin e politikave industriale dhe tregtare me qëllim të përmirësimit të bilancit tregtar. Zv. Ministri Mjeku përmbyll fjalimin e tij me dëshirën dhe vullnetin që Kosova të raportojë vullnetarisht për progresin në lidhje me Agjendën 2030, meqë ky raport do të pasqyronte qartë se ku do të duhet të orientohet më shumë Kosova në përmbushjen e objektivave.

Folësja e dytë e ngjarjes hapëse ishte znj. Fatmire Kollçaku – Mullhaxha, Kryesuese e Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm e cila filloj fjalimin e saj me një historik të shkurtër mbi formimin dhe konsolidimin si dhe sfidat që ka pasur KZhQ si trup koordinues për zbatimin e Agjendës 2030 që nga themelimi i tij në vitin 2018. Tutje znj. Kollçaku – Mullhaxha, në fjalimin e saj ka përmendur

planin e punës të këtij Këshilli, si dhe fokusin e tij në 4 pika kryesore: hartimin e ligjeve, buxhetimi, mbikëqyrja dhe përfaqësimi, si dhe raportet bashkëpunuese që ka me institucionet tjera e organizatat ndërkombëtare e lokale. Znj. Kollçaku – Mulhaxha shtoi gjithashtu se Këshilli tani është duke punuar me ASK që të formojnë një qendër statistikore brenda Këshillit në mënyrë që deputetët të kenë qasje më lehtë në të dhëna. Përveç zbatimit të përgjithshëm, znj. Mulhaxha theksoj se Këshilli do të punojë me ekspertë të caktuar edhe në indikatorë specifikë, për zbatim sa më të mirëfilltë të Agjendës 2030.



*Fig 6: Gjatë fjalimit të z. Ejupi, znj. Suokko dhe z. Oberhuber në ngjarjen hapëse të Forumit*

Znj. Suokko, ushtruese e detyrës së Koordinatorës për Zhvillim nga Kombet e Bashkuara, si dhe përfaqësuese rezidente e UNDP-së ishte folësjja e rradhës në ngjarjen hapëse. Në fjalimin e saj, znj. Suokko përmendi zotimin që Kosova e ka deklaruar për zbatimin e Agjendës 2030 duke bërë hapa fillestarë në këtë drejtim, si miratimin e Rezolutës, përfshirjen e saj në programe strategjike si dhe formimin e KZhQ. Gjithashtu znj. Suokko konfirmoj edhe njëherë mbështetjen e Kombeve të Bashkuara ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës, Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm, Zyrës për Planifikim Strategjik për zbatimin e Agjendës 2030.

Përveç mbështetjes së madhe gjatë zbatimit të projektit dhe organizimit nga NALAS e veçanërisht nga z. Joachim Roth. Ky i fundit nderoj Forumin me prezencën e tij në ngjarjen hapëse, poashtu edhe si moderues i tryezës së parë të diskutimit. Z. Roth në fjalimin e tij theksoj se hartëzimi social është metodologji jashtëzakonisht e nevojshme për të na ofruar informacione dhe të dhëna, në mënyrë që vendimet të merren duke u bazuar në problematika të jetës së përditshme, si dhe politikat të zhvillohen duke u bazuar në të dhëna për grupet e synuara, në këtë rast grupet e marginalizuara apo të cënuara. Z. Roth, në fjalimin e tij përmendi gjithashtu se gjendja pandemike ka bërë të konsiderojmë primare nevojën e grupeve të cënueshme për përmirësim të politikave sociale, dhe e gjithë kjo duke u drejtuar e bazuar në Agjendën 2030, e cila tenton të jetë gjithëpërfshirëse pa e anashkaluar askënd.

Përfaqësues i GIZ-it, njëkohësisht drejtori për Kosovë dhe Maqedoni të Veriut z. David Oberhuber, përmendi gjithashtu rëndësinë e zbatimit të Agjendës 2030 në Kosovë dhe mbështetjen që GIZ e ofron në këtë proces global. Z. Oberhuber përmendi gjithashtu se puna me Institutin

INDEP për zbatimin e kësaj agjende në vitet e fundit, ka filluar pikërisht në nivelin lokal, dhe janë bërë hapa e parë por domethënës në këtë drejtim përkundër që Kosova nuk është e obliguar të zbatojë këtë proces. Parimi i gjithëpërfshirjes: Lënia e askujt prapa përmes hartëzimit social është shembull i mirë që duhet të replikohet edhe në komuna të tjera. Ndër tjerash z. Oberhuber theksoj se Agjenda 2030 dhe OZhQ-të janë kornizë që duhet integruar në planet strategjike dhe duhet prioritetuar objektivat që Kosova dëshiron të koncentrojë vëmendjen.

Drejtori ekzekutiv i AKK z. Sazan Ibrahimimi si dhe drejtori ekzekutiv i Institutit INDEP z. Burim Ejupi, ishin folësit e fundit dhe njëkohësisht bashkëpunëtorët organizues të Forumit Politik të Agjendës 2030. Në fjalimin e tij hapës, Z. Ibrahimimi theksoj se institucionet lokale luajnë rol thelbësor në zbatimin e OZhQ-ve, dhe se përkrahja e institucioneve të nivelit qendror kërkohet dhe nevojitet në vazhdimësi jo vetëm në aspekt financiar por edhe me hartimin e kornizave legjislative të nevojshme për të operacionalizuar zbatimin e Agjendës 2030 në mënyrë konkrete. Ndërsa, z. Ejupi nga Instituti INDEP përmendi se përpilimi i Raportit Vullnetar Kombëtar (VNR) do të ishte hap i duhur në mënyrë që të gjurmohej progresi i Kosovës në arritjen e OZhQ-ve. Tutje z. Ejupi theksoj se në bashkëpunim me AKK po punojnë që të ngritin vetëdijen dhe kapacitetin human në nivel lokal për lokalizimin e mirëfilltë të OZhQ-ve. 'Instituti INDEP punon në vazhdimësi prej vitit 2018 për këtë Agjendë, dhe do të vazhdoj punën duke dhënë kontribut dhe ndihmë për institucionet e nivelit lokal dhe qendror, deri sa të ketë progres konkret të kësaj Agjende' – përmbylli fjalimin e tij z. Ejupi.

### *Tryeza diskutuese me titull 'Hartëzimi social për Qasjen Gjithëpërfshirëse – kornizë udhëzuese për hartimin e politikave të bazuara në të dhëna në nivel lokal'*

Pjesë kontribuese e Forumit Politik për Agjendën 2030 ishin edhe tryezat e diskutimit, në të cilat u diskutua nga hisedarë përkatës për zbatimin e Agjendës 2030.



*Fig 7. Gjatë prezantimit të të gjeturave nga hartëzimi social për komunën e Vitisë dhe Hanit të Elezit*

Nga këto tryeza të diskutimit u mblodhën dhe u nxorrën rekomandime për secilën temë të diskutuar. Tryeza e diskutimit me titull *'Hartëzimi social për Qasjen Gjithëpërfshirëse – kornizë udhëzuese për hartimin e politikave të bazuara në të dhëna në nivel lokal'* u moderua nga z. Joachim Roth, zyrtar i BE-së në NALAS dhe kishte në përbërje z. Naim Qelaj, Avokat i Popullit në Institucionin e Avokatit të Popullit, z. Mentor Morina, zyrtar në departamentin për punë sociale në MFPT, z. Afrim Maliqin drejtor ekzekutiv i organizatës HANDIKOS, si dhe znj. Nergis Gjinolli, koordinatore e projektit në AKK. Kjo e fundit, fillimisht prezantoi të gjeturat nga hartëzimi social në komunën e Hanit të Elezit dhe Vitisë, për të nisur më pas diskutimin rreth të gjeturave të këtyre dy pilot-projekteve në dy komunat e lartpërmendura, si dhe replikimin e këtyre shembujve dhe mekanizmave të hartëzimit social në fusha të tjera dhe për të gjitha grupet e cenueshme. Me implementimin e duhur të rekomandimeve të raportit të



hartëzimit social, do të mund të replikohej kjo edhe në komunat tjera të Kosovës.

Gjatë tryezës u diskutua se në studimin final për hartëzimin social, janë mbledhur të dhëna që kanë për qëllim vlerësimin e mangësive të ofrimit të shërbimeve publike sociale. Mangësia e parë e përmendur u diskutua të jetë mungesa e informimit të qytetarëve për të drejtat e tyre, për të vijuar më pas me problemin e ofrimit të shërbimeve jo-kualitative pikërisht për shkak të mungesës së të dhënave. Gjetjet nga ky studim do të përdoren për të përmirësuar këto shërbime gjithmonë duke u mbështetur në parimin e gjithë-përfshirjes ‘Mos lënja e askujt prapa’, si pjesë e Agjendës 2030, duke theksuar edhe ndryshimet që duhet bërë në planet strategjike të komunave si dhe dizajnimin e politikave më të mira sociale për gjithë-përfshirje në skema sociale të shërbimeve shëndetësore. Për më tepër, gjatë diskutimit u përmend edhe rëndësia e institucionit të Avokatit të Popullit në këtë drejtim, duke u theksuar se zbatimi i hartëzimit social, kështu duke kontribuar në zbatimin e Agjendës 2030 do të ndihmohej edhe puna e këtij institucioni. Por për t’u zbatuar kjo, nevojitet edhe koordinimi me institucione të tjera. Nga ana e përfaqësuesit të MFPT z. Morina, u përmend se objektivi kryesor e nivelit qendror është përmirësimi i shërbimeve të integruara duke u bazuar në nevojat e të gjithë qytetarëve, si dhe ndërmarrja e disa hapave konkretë që Ministria do të bëjë në vijim duke diskutuar detajisht krijimin e një platforme për shpërndarjen e drejtë të fondeve në nivelin komunal. Gjatë diskutimit u përmend edhe kontributi i organizatës HANDIKOS në hartëzimin social për dy komunat e Hanit të Elezit dhe Vitisë, si dhe u diskutua diskriminimi i vazhdueshëm dhe shkelja e të drejtave të personave me nevojat të veçanta, e u përmend ndryshimi i legjislacionit dhe zbatimi i rekomandimeve të OBSH-së si hapa konkretë për të ndihmuar këto grupe të cenueshme, njëkohësisht duke kontribuar në zbatimin e Agjendës 2030.

*Tryeza diskutuese me titull ‘Një perspektivë e përgjithshme mbi sfidat e mbledhjes së të dhënave në nivel kombëtar në Kosovë: Si ndikon mungesa e të dhënave cilësore në zbatimin e duhur të Agjendës 2030’*

Tryeza e dytë diskutuese trajtoi sfidat e mbledhjes së të dhënave si dhe mungesën e të dhënave cilësore për zbatimin e Agjendës 2030 në Kosovë. Tryeza u moderua nga Valon Feka në cilësinë e eksperimentit të pavarur, dhe bashkëbiseduesit e tjerë ishin znj. Fatmire Kollçaku – Mulhaxha, kryesuese e KZhq, z. Ilir Berisha, drejtor ekzekutiv në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, z. Adnan Ahmeti, zyrtar i lartë për planifikim strategjik në ZPS, znj. Shqipe Krasniqi, koordinatore për Agjendën 2030 në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm në Kuvendin e Kosovës si dhe z. Omar Siddique, shef i zyrës dhe këshilltari kryesor teknik në UN Habitat.

Diskutimi i thukët dhe qasja e larmishme nga akterë të ndryshëm, bëri që tema e diskutimit të trajtohej në mënyrën më horizontale, duke përfshirë kështu institucione publike, agjenci të pavarura e organizata ndërkombëtare. Të gjithë këta akterë



Fig 8: Znj. Kollçaku në tryezën diskutuese mbi sfidat e mbledhjes së të dhënave

relevante për të identifikuar sfidat e nevojshme për adresimin e këtij problem. Në tryezë u përmend rëndësia e të dhënave të mbledhura në nivelin lokal dhe pse Agjenda 2030 duhet të zbatohet në nivel lokal. Kjo u diskutua për shkakun se komunat janë më afër qytetarit, dhe të dhënat që mbledhen në nivelin komunal flasin direkt për sfidat e ndryshme të qytetarëve. Për më tepër u diskutua se Kosova ka nevojë për një metodë të standardizuar për mbledhjen e informacioneve për të ndërtuar një kornizë kombëtare për raportimin e OZhQ-ve. Po për këtë arsye duhet të rritet bashkëpunimi dhe ndër-koordinimi në mes të institucioneve të ndryshme, sepse patjetër që një institucion i vetëm nuk mund të ketë të gjitha të dhënat e nevojshme sidomos për zbatimin e Agjendës 2030.

Gjatë këtij diskutimi u përmenden sfida si mungesa e burimeve njerëzore, mungesa e sistematizimit të të dhënave, si dhe mungesa e ndër-veprimit institucional, me të cilat përballen institucione të ndryshme si ASK e KZhQ-së. U ripërmend rëndësia kryesore e disponueshmërisë së të dhënave për zbatimin e Agjendës 2030, si dhe u theksua planifikohet krijimi i një platforme nga ana e ASK-së që do të lehtësojë qasjen në të dhëna. Diskutimi u përmbyll me një deklaratë nga ana e z. Siddique i cili tha se duke bashkëpunuar, rritet edhe njohuria dhe mundësohen mënyra të ndryshme të punohet në mënyrë të përbashkët për zbatimin e OZhQ-ve, kjo e theksuar, sidomos në nivelin komunal.

### *Tryeza diskutuese me titull 'Partneritetet dhe bashkëpunimet ndërsektoriale për zhvillim të qëndrueshëm: Roli i sektorit privat sa i përket 'rritjes së gjelbër'*

Tryza e tretë dhe e fundit e Forumit Politik për Agjendën 2030 dhe OZhQ-të, tentoi të rendis sfidat dhe përfitimet e bashkëpunimeve ndër-sektoriale. Në këtë diskutim u theksua veçanërisht rëndësia e sektorit privat dhe atij publik për zhvillimin e qëndrueshëm dhe atë që quajmë rritje 'të gjelbër' apo tranzicionin nga ekonomia lineare në atë qarkore. Të ftuar për të bashkëbiseduar në tryezën e tretë të diskutimit ishin: znj. Antigona Limani, kryetare e bordit në rrjetin CSR, Enisa Serhati, menaxhere e portfolios në UNDP, Berat Rakovica, drejtor ekzekutiv në organizatën 'Marakli t'Biciklave' dhe Fatos Hasani, nga banka Pro Credit.

Edhe ky diskutim theksoj edhe njëherë rëndësinë e bashkëpunimit ndër-institucional dhe ndër-sektorial. Nevoja e madhe e përfshirjes së sektorit privat në proceset politik-bërëse është bërë pamohueshmërisht e domosdoshme për arritjen e objektivave të caktuara zhvillimore, e gjithashtu



edhe për progres konkret në përparimin e Agjendës 2030. U diskutua se sektori privat kontribuon në mbushjen e buxhetit të shtetit dhe garanton të ardhura për mijëra persona duke qenë kështu akselatori kryesor për rritjen e BPV-së në vend. Por u përmend gjithashtu se me këtë aktivitet të madh ekonomik vjen në shprehje edhe impakti mjedisor që ky aktivitet ekonomik e ka. Sektori privat konsiderohet si burim i zgjidhjes dhe

*Fig 9: Tryeza e fundit diskutuese në temën 'Rritja e Gjelbër'*

problemit dhe është akter jashtëzakonisht i rëndësishëm në avancimin e Agjendës 2030. Për më tepër në tryezën diskutuese u përmend se respektimi i standardeve është hapi primar që entitetet e sektorit privat mund të bëjnë për të zbatuar Agjendën 2030. si dhe mund të bëhet burim i financimit të zgjidhjeve që ndihmojnë zbatimin e Agjendës 2030 – u tha ndër tjerash në këtë diskutim në Forumin Politik për Agjendën 2030.

Përveç mënyrave që sektori privat mund të ndihmojë për zbatimin e Agjendës 2030, u diskutua gjithashtu edhe për inkurajimin dhe shtytjen e entiteteve private nga politik-bërësit që të nxisin transformimin dhe të fokusohen në drejtim të qëndrueshëm. U theksua se kjo nuk mund të bëhet pa nxitjen e kërkesave posht-lartë dhe pa monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis nga ana e institucioneve. Poashtu, u përmend roli i subvencioneve dhe fondeve për të inkurajuar entitetet ekonomike që kanë impakt të ulët mjedisor dhe impakt pozitiv në shoqëri. Pikë tjetër e rëndësishme e përmendur në këtë diskutim ishte roli thelbësor i organizatave në përkrahjen e shtyllave për transformimin e mënyrës së të bërit biznes nga ajo konvencionale në të qëndrueshmen duke ndihmuar kështu në plotësimin e OZhQ-ve.

## Zotimi i institucioneve për bashkëpunim të vazhdueshëm

Forumit Politik për Agjendën 2030, forum ky i llojit të veçantë ka mbledhur në një hapsirë palë e akterë të ndryshëm të interes, të gjithë të rëndësishëm për të kontribuar në zbatimin e përgjithshëm të Agjendës 2030. Të ftuar për të kontribuar ishin institucionet zyrtare të Republikës së Kosovës si Qeveria, ministritë e caktuara, agjencitë e pavarura, institucionet lokale për të vazhduar me organizatat ndërkombëtare, organizatat e shoqërisë civile vendore, sektorin privat e hisedarë të tjerë si të rinjtë, të kyçur e të interesuar në zbatimin e Agjendës 2030 dhe OZhQ-ve në Kosovë. Forumi ka krijuar bazat e para për koordinim dhe partneritet ndër-institucional dhe ndër-sektorial përmes nënshkrimit të një Deklarate të Përbashkët për bashkëpunim dhe përpilimit të rekomandimeve të shumta të përmbledhura në tri raporte të ndryshme të cilat do t'i dorëzohen Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm. Për më tepër, me nënshkrimin e kësaj Deklarate dhe inkorporimin e rekomandimeve të përpiluara gjatë këtij Forumi do të ndihmohet trupi koordinues për Agjendën 2030 të përforcojë planin e veprimit të tij në raport me zbatimin e agjendës dhe të përfshijë institucione të caktuara, të rëndësishme për një veprim gjithëpërfshirës për OZhQ-të.

*Deklaratat e Përbashkëta* u nënshkruan nga Instituti INDEP, AKK, Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Zyrës për Planifikim Strategjik të cilat shpallin hartëzimin social si mjet thelbësor për matjen e progresit, rritjen e bashkëpunimit në mes palëve, promovimin e parimit të gjithëpërfshirjes dhe përcjelljen e suksesit në realizimin e Agjendës 2030. Për më tepër deklarata përmbajti pikën tjetër të punës së përbashkët të institucioneve për të promovuar rritëzimin social dhe njohin rolin e njëri-tjetrit në përmbushjen e Agjendës 2030 në njërën anë, dhe angazhohen në ndihmën e ndërsjellë në këtë proces në anën tjetër si dhe koordinim të përbashkët të institucioneve dhe grupeve të ndryshme shoqërore. Pra si përfundim të sugjerohet dhe të pajtohet bashkërisht për mekanizmin për përmirësimin dhe shkëmbimin e të dhënave të mbledhura në nivel lokal ndërmjet komunave të

Kosovës dhe institucioneve të nivelit qendror me qëllim të përmirësimit të politikëbërjes drejtë përmbushjes së Objektivëve të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

## Rekomandimet e dala nga grupet punuese

Pjesë thelbësore e forumit ishte puna me grupet punuese të cilët kishin në përbërje palët më të rëndësishme lokale dhe qendrore për zbatimin e Agjendës 2030. Rekomandimet e dala nga dy grupet e punës pritet të shërbejnë si një udhërrëfyes në zhvillimin e masave dhe aktiviteteve të mëtejshme në nivel qendror dhe lokal në lidhje me politik-bërjen dhe të parashikojnë veprime vepruese. hapat për vendosjen e koordinimit ndërmjet institucioneve të nivelit lokal dhe kombëtar.

Nisur nga diskutimet për strukturën e KZQ-së, u konsiderua se ristrukturimi i KZhQ-së bazuar në një model të propozuar 3-nivelësh do të kontribuonte në një koordinim të zgjeruar ndër-sektorial dhe ndër-institucional për zbatimin e SDG-ve. Kjo strukturë do të ndahej në tri entitete: sekretariati, këshilli dhe grupet punuese. E nevojshme u konsiderua edhe prania e përfaqësuesve të sektorëve dhe subjekteve relevante në Këshill, e cila do të ofronte një mundësi në vetvete për të shkëmbyer, koordinuar dhe përmirësuar veprimet drejt përmbushjes së Agjendës 2030 dhe SDG-ve.

Rekomandim tjetër i dalur nga grupet punuese ishte nevoja për koordinim të rregullt me komunitetin e donatorëve që do të ndihmonin drejt formësimit më të mirë të politikave dhe veprimeve për Agjendën 2030, por ato potencialisht do të reflekttoheshin në skemën e financimit të donatorëve përkatës, të cilat përfundimisht do të ushqeheshin me projekte lokale dhe qendrore, ose projekte të udhëhequra nga shoqëria civile.

Mungesa e komunikimit dhe koordinimit të ngushtë ndërmjet nivelit lokal dhe atij qendror të qeverisjes, është dukshëm e theksuar. Për këtë arsye u rekomandua identifikimi i mundshëm për emërimin e nëpunësve civilë në secilën komunë si koordinatorë lokalë për OZhQ-të. Puna e tyre do të mund të udhëhiqej dhe ndihmohej nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, përfaqësuesit e të cilit do t'i kanalizonin kërkesat në KZhQ përmes pranisë së tyre.

Rekomandim tjetër është nevoja e jashtëzakonshme për të investuar në një fushatë ndërgjegjësimi dhe edukimi të synuar dhe të projektuar mirë. Mungesa e vazhdueshme e njohurive mbi zhvillimin e qëndrueshëm dhe Agjendën 2030 pengon veprimin e duhur dhe koordinimin e mirë ndër-institucional në këtë drejtim. E gjithë kjo nuk do të mund të mundësohen pa buxhetimin e duhur të Agjendës 2030 në mënyrë që të ecet përpara me strategjinë e planin e veprimit.

Rekomandim përfundimtar është përdorimi i hartëzimi social si mjet thelbësor për matjen e progresit, rritjen e bashkëpunimit në mes palëve, promovimin e parimit të gjithëpërfshirjes dhe përcjelljen e suksesit në realizimin e Agjendës 2030. Padyshim që e gjithë kjo nuk është e mundur të bëhet pa një strategji e plan veprim të projektuar mirë. Delegimi i kompetencave të caktuara në nivel lokal është thelbësor për një zbatim të duhur të Agjendës 2030 dhe përfshirja e të gjitha institucioneve relevante, organizatave jo-qeveritare e sektorit privat është përfundimisht e domosdoshme për të pasur përparuar në drejtim të Agjendës 2030



## SHTOJCA

- REKOMANDIMET NË FORMË TABELARE (Relevante për secilin institucion)
- AGJENDA
- DEKLARATAT

|                                                                                                                                                                                                                                   |   | <b>Rekomandimet</b>                                                                                                                             | <b>Institucionet përgjegjëse</b>                                                                                                                                                                | <b>Veprimet e nevojshme</b>                                                                                                                                                                                                                      |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Grupi punës 1: Si mund të ndihmojë koordinimi ndërsektorial dhe ndërinstitutional ndërmjet nivelit vendor dhe qendror dhe sektorit privat në avancimin e agjendës 2030 dhe përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm | 1 | Nevoja për të pasur më shumë se një seancë parlamentare në vit për OZHQ-të                                                                      | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm</li> <li>• Parlamenti i Kosovës</li> </ul>                                                                        | <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Një kërkesë zyrtare e këshillit drejtuar kryesisë së Kuvendit</li> <li>○ Një ftesë drejtuar partive politike dhe grupeve parlamentare</li> </ul>                                                        |
|                                                                                                                                                                                                                                   | 2 | Nevoja për të afruar punën e Këshillit me shkollat dhe institucionet arsimore për të siguruar mësim të qëndrueshëm dhe përfshirje të koncepteve | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm</li> <li>• Ministria e Arsimit</li> <li>• Drejtoritë komunale të arsimit</li> </ul>                               | <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Takime të përbashkëta mes Këshillit dhe Ministrisë së Arsimit</li> <li>○ Vizitë zyrtare e Këshillit në drejtoritë komunale të arsimit</li> </ul>                                                        |
|                                                                                                                                                                                                                                   | 3 | Organizimi një herë në vit i një seance parlamentare për OZHQ-të, qëllimin dhe përmbushjen e tyre                                               | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Parlamenti i Kosovës</li> <li>• Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm</li> </ul>                                                                        | <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Takime me grupe parlamentare</li> <li>○ Koordinimi mes liderëve dhe partive politike</li> <li>○ Dorëzimi i raporteve në Këshill dhe shtimi i informacionit</li> </ul>                                   |
|                                                                                                                                                                                                                                   | 4 | Përfshirja e SDG-ve në procesin e hartimit të legjislacionit                                                                                    | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Komisioni Parlamentar për Legjislacion</li> <li>• Grupi punës për Rregulloren e re të Punës</li> <li>• Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Avokimi për një nen në rregulloren e re të Kuvendit për ta bërë këtë të detyrueshme</li> <li>○ Shtimi i tabele përputhshmërie të OZHQ-ve në normat e procesit legjislativ</li> </ul>                    |
|                                                                                                                                                                                                                                   | 5 | Komisionet parlamentare të mbikëqyrin periodikisht Qeverinë dhe organet e tjera të pavarura për të siguruar përputhjen me SDG-të                | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Komisionet Funktionale Parlamentare</li> <li>• Zyra Ndërlidhëse për Agjencitë e Pavarura</li> </ul>                                                    | <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shtimi i dëgjimeve publike në planet e veprimit të komisioneve funksionale parlamentare</li> <li>○ Ndryshimi i manualit për raportimin e agjencive të pavarura – përmes Kryesisë së Kuvendit</li> </ul> |
